



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
TIRANË

NR.REGJ.THEM. 10348/2942/1283

DATE 25.10.2021

DT.REGJ. 03.04.2019

V E N D I M
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e përbërë nga:

Alma KODRALIU – GJYQTARE

Asistuar nga **Sekretare Gjyqësore Gencjana Dada**, sot me datë 25.10.2021, mori në shqyrtim, kërkesën për heqjen e masës për sigurim padie lidhur me çështjen civile që i përket:

PADITËS:

Shoqëria "DIGIT-ALB" sh.a me seli në Tiranë, Kashar, Rruga "Pavarësia" nr. 39, identifikuar nga Nipt me Nr. K 41719004 D përfaqësuar nga znj. Vjollca Hoxha dhe z.Arben Taip, në cilësinë e administratorëve. e-mail: Vjollca. Hoxha@digitalb.tv përfaqësuar në gjykim me autorizim përfaqësimi me nr. 441 prot datë 01.04.2019 nga z. Redi Lamaj dhe në referim të prokurës së përgjithshme me nr. 4450 rep, nr. 893 kol, datë 01.10.2019 nga av. Ilir Dode me nr.licence 5216, nr.nipti L 21402505 P, anëtar i dhomës së avokatisë Tiranë.

I PADITUR:

Alban Jaho i biri i Nuriut dhe Nazmies, i dtl 31.05.1969, lindur dhe banues në Tiranë në adresën: Rruga "Vaso Pasha", Pall nr. 31, Apartamenti nr. 4, përfaqësuar në gjykim me deklaram nga av. Neshat Fana me nr. licence 929, nr. nipti L 52212081 M, anëtar i dhomës së avokatisë Tiranë.

OBJEKTI:

- Zhdëmtimin e dëmit 100.000 (njëqind mijë) Euro që ish administratori i shoqërisë "Digitalb" sh.a, Alban JAHO me veprimet dhe vendimarrjet e tij si administrator i ka shkaktuar shoqërisë "Digitalb" sh.a. - Lejimin e masës së sigurimit të padisë,



BAZA LIGJORE:

duke urdhëruar vendosjen e sekuestros mb aksionet që Alban Jaho si aksioner ka dhe zotëron në shoqërinë "Digitalb" sh.a.
Nenet 14, 16 dhe 163 të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe shoqëritë tregëtare" (i ndryshuar). Nenet 32 gërma "a", 154, 202-206 të Kodit të Proçedurës Civile.

VËREN :

Palët paditëse i janë drejtuar kësaj gjykate me padinë e mësipërme, pjesë e së cilës ishte dhe kërkesa për marrjen e masës së sigurimit të padisë, duke urdhëruar vendosjen e sekuestros mbi aksionet që i padituri Alban Jaho zotëron si aksioner i palës paditëse.

Pala paditëse, Shoqëria "DIGITALB" sh.a është regjistruar si person juridik që prej datës 18.05.2004 me objekt të veprimtarisë së saj tregtare në fushën e : "Ndërtim, tregtim, të sistemeve të telekomunikacioneve...etj". Referuar përmbajtjes së ekstraktit të sipërcituar rezulton që i padituri në këtë gjykim Alban Jaho të ketë ushtruar funksionin e administratorit të shoqërisë "DIGIT - ALB" sh.a deri më datë 17.01.2019 për shkak se në referim të vendimit të asamblesë së aksionarëve datë 17.01.2019 shtë vendosur: "Largimi nga detyra e administratorit Z. Alban Jaho". 2. Referuar përmbajtjes së kërkesës- padisë së paraqitur nga pala paditëse shoqëria "DIGIT - ALB" sh.a rezulton që kjo e fundit të ketë pretenduar se i padituri në këtë gjykim Alban Jaho gjate periudhës që ka ushtruar funksionin e administratorit të shoqërisë i ka shkaktuar dëm shoqërisë "Digit - Alb" sh.a në shumën 100.000 (njëqind mijë) Euro.

Sipas pretendimeve të palës paditëse një dëm i tillë ishte shkaktuar si rezultat i faljes së një detyrimi prej 100,000 (njëqind mijë) Euro që i padituri në këtë gjykim Alban Jaho i kishte bërë shoqërisë "Tibo", detyrim ky i cili rridhte nga marrëdhënia kontraktore që shoqëria "Digit - Alb" kishte pasur me shoqërinë "TIBO".

Lidhur me këtë padi, Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane me Vendim "Per marrjen e mases se sigurimit te padise Nr.Regj.Them.7596 (Dt.Regj. 03.04.2019) date 14.06.2019, vendosi: Pranimin e kerkeses se pales paditese Digitalb sh.a. 1. Vendosjen e sekuestros conservative mbi aksionet qe i padituri Alban Jaho zoteron ne shoqerine Digitalb sh.a. perkundrejt vendosjes si garanci pasurore nga ana e pales paditese shoqerise Digitalb sh.a. te shumes 20 000 Euro shume kjo e cila duhet te depozitohet nga ana e pales paditese shoqerise Digitalb sh.a. ne nje nga bankat e nivelit te dyte ne RSH per llogari te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane me pershkrimin: "Per sigurimin e padise". 2. Masa e sigurimit te padise do ti shtrije efektet e veta nga data e depozitimit te shumes se sipercituar nga pala paditese shoqeria Digitalb sh.a.

Ndërkaq, rezulton se i padituri në këtë gjykim Alban Jaho, ka ngritur padi, si vijon: Paditës: Alban Jaho; Të Paditur: 1. Shoqëria "DigitAlb" sh.a; 2. Itan Dritan Hoxha; 3. Shoqëria "Loresa"

sh.p.k ; 4. Redia Dritan Hoxha dhe 5. Shoqëria "E&E Investment" sh.p.k, Me Objekt: 1. Konstatimin e pavlefshmërisë së Vendimit Nr.Extra, datë 17.01.2019 të Aksionarëve të shumicës së asamblesë së përgjithshme për shkarkimin e administratorit, çregjistrimin e këtij vendimi nga Qendra Kombëtare e Biznesit (Regjistrimit) të datës 23.01.2019 dhe urdhërimin e fshirjes së këtij regjistrimi nga aktet e shoqërisë Digitalb të publikuara në regjistrat e Qendrës Kombëtare të Biznesit, si dhe detyrimin e palës së paditur shoqëria "DigitAlb" sh.a. të më rikthejë në pozicionin e mëparshëm si administrator; 2.Konstatimi i pavlefshmërisë së Vendimit Nr.Extra datë 17.01.2019 të Aksionarëve të Asamblesë së Përgjithshme për emërimin e Administratorëve të Përkohshëm, çregjistrimin e vendimit nga Qendra Kombëtare e Bisnesit (Regjistrimit) të datës 23.01.2019 dhe urdhërimin e fshirjes së këtij regjistrimi nga aktet e shoqërisë Digitalb të publikuara në regjistrat e Qendrës Kombëtare të Bisnesit; 3. Marrjen e masës së sigurimit të padisë: Pezullimin e zbatimit të sipërcituara (pika 1 dhe 2 më lart) të firmosura nga disa nga Aksionarët e Digitalb sh.a. Urdhërimin e Qendrës Kombëtare të Biznesit (Regjistrimit) të datës 23.01.2019 të realizuara për shkarkimin e administratorit të shoqërisë dhe emërimin e administratorëve të perkohshëm, deri në zgjidhjen e çështjes në themel nga Gjykata; 4. Detyrimin e të paditurit të më paguajë dëmshpërblimin si vijon: - Pagesën e pagës mujore bruto për 16 muaj, për periudhën 17.01.2019 deri më 17.05.2020 për shkak të shkarkimit para përfundimit të mandatit dhe pa arsye të përcaktuara në Ligjin "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar) dhe Statutin e shoqërisë "Digitalb" të miratuar me vendimin nr. 6, datë 17.06.2011 (i ndryshuar).Pagesën e dëmshpërblimeve të tjera për mungesën e njoftimit sipas parashikimit në ligje të tjera konkretisht Kodit të Punës për çështje që lidhen me marrëdhëniet e punës, për shpërblimin për vjetërsi dhe pagesën e lejes vjetore të pakonsumuar.- Pagesën e dëmit jopasuror në zbatim të parashikimeve të nenit 625 pika b), nenit 626 dhe nenit 647/a të Kodit Civil; 5. Dhënien e vendimit me ekzekutim të perkohshëm.

Me vendimin e ndërmjetëm të dt. 04.11.2019, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur: Pezullimin e gjykimit të çështjes civile me Nr.Regj.Them 7596, date regjistrimi 03.04.2019 me palë ndërgjyqëse Paditës: Shoqëria "DIGIT-ALB" sh.a; I Paditur: Alban Jaho; me Objekt: - Zhdëmtimin e dëmit 100.000 (njëqind mijë) Euro që ish administratori i shoqërisë "Digitalb" sh.a, Alban JAHO me veprimet dhe vendimarrjet e tij si administrator i ka shkaktuar shoqërisë "Digitalb" sh.a. Lejimin e masës së sigurimit të padisë, duke urdhëruar vendosjen e sekuestros mbi aksionet që Alban Jaho si aksioner ka dhe zotëron në shoqërinë "Digitalb" sh.a. deri në zgjidhjen me vendim gjyqësor të formës së prerë të çështjes civile të regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me nr. 10348 Akti, datë regjistrimi 01.07.2019 me pale ndërgjyqëse dhe objekt: Paditës: Alban Jaho; Të paditur: Shoqëria "DigitAlb" sh.a; Itan Dritan Hoxha; Shoqëria "Loresa" sh.p.k; Redia Dritan Hoxha; Shoqëria "E&E Investment" sh.p.k, me objekt: 1. Konstatimin e pavlefshmërisë së Vendimit Nr.Extra, datë 17.01. 2019 të Aksionarëve të shumicës së asamblesë së përgjithshme për shkarkimin e administratorit, çregjistrimin e këtij vendimi nga Qendra Kombëtare e Biznesit (Regjistrimit) të datës 23.01. 2019 dhe urdhërimin e fshirjes së këtij regjistrimi nga aktet e shoqërisë Digitalb të publikuara në regjistrat e Qendrës



Kombëtare të Biznesit, si dhe detyrimin e palës së paditur shoqëria "Digitalb" sh.a, të më rikthejë në pozicionin e mëparshëm si administrator. 2. Konstatimi i pavlefshmërisë së Vendimit Nr.Extra datë 17.01. 2019 të Aksionareve të Asamblesë së Përgjithshme për emëtimin e Administratorëve të Përkohshëm, çregjistrimin e vendimit nga Qendra Kombëtare e Biznesit (Regjistrimit) të datës 23.01.2019 dhe urdhërimin e fshirjes së këtij regjistrimi nga aktet e shoqërisë Digitalb të publikuara në regjistrat e Qendrës Kombëtare të Bisnesit."

Me kërkesën e prot në gjykatë me nr. 3482 dt. 30.04.2021, pala paditëse, Shoqëria "Digitalb" sha, ka kërkuar rifillimin e gjykimit të kësaj çështje, për shkak se kanë rënë shkaqet për të cilat ajo është pezulluar. Konkretisht, sipas kërkesës, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane me Vendim Nr.4468 date 21.10.2020 ka vendosur: "*Pranimin pjeserisht të padisë Detyrimin e pales se paditur Digitalb sh.a. të demshperbleje palen paditese me tre muaj paga mujore si pasoje e zgjidhjes së menjehereshme dhe të pajustificuar të kontrates së punes Detyrimin e pales se paditur Digitalb sh.a. të demshperbleje palen paditese me tre muaj paga mujore per zgjidhjen e kontrates së punes pa respektuar afatin... Detyrimin e pales se paditur Digitalb sh.a. të demshperbleje palen paditese me dy muaj paga mujore per zgjidhjen e kontrates së punes pa respektuar proceduren... Detyrimin e pales se paditur Digitalb sh.a. të paguaje pales paditese demshperblimin per vjetersi ne pune... Rrezimin e padise per pjesen tjeter.*" Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 01.12.2020.

Në vijim të sa me sipër, si dhe në kushtet kur, shkak i pezullimit ka rënë (Ceshtja civile Nr.10348 2942 Regj.Them. Dt. Regj.01.07.2019 ka përfunduar dhe Vendimi Nr.4468. Date 21.10.2020 ka marrë formë të prerë në datën 01.12.2020), në mbështetje të nenit 298 i Kodit të Procedurës Civile, pala paditëse Shoqëria Digitalb sha ka kërkuar vazhdimin e gjykimit të ceshtjes civile Nr.Regj.Them.7596 (Dt.Regj. 03.04.2019).

Nga ana e gjykatës, janë thirrur palët në seancën e dt. 25.10.2021, në të cilën është vendosur rifillimi i gjykimit të çështjes dhe janë ftuar palët e pranishme të paraqesin kërkesa paraprake lidhur me gjykimin. Përfaqësuesi i palës paditëse ka kërkuar heqjen dorë nga masa e sigurimit të kërkuar dhe të vendosur nga ana e gjykatës. Sipas përfaqësuesit të palës paditëse dhe të paditurit janë duke u kryer përpjekje për zgjidhjen me pajtim të çështjes.

Neni 207 i K.Pr.Civile parashikon se gjykata mund të marrë vendim për heqjen e masës së sigurimit, me kërkesën e njërit prej palëve, kur çmon se janë zhdukur kushtet për të cilat ajo është vendosur. Në rastin konkret, në kushtet kur pala paditëse e cila ka kërkuar marrjen e masës kërkon heqjen e saj, gjykata vlerëson se nuk ekzistojnë më shkaqet për të cilat masa e sigurimit është marrë.

Ndërkaq, gjykata vëren dhe faktin se garancisë bankare leshuar nga "Tirana Bank" sha me Nr.CO914/170619 date 18.06.2019 për qëllime të vendosjes së kësaj mase sigurimi i ka përfunduar afati dhe si rrjedhojë, në kushtet kur nuk është paraqitur garanci e re, konsiderohet e shuar.



PËR KËTO ARSYE

Gjykata, mbështetur në nenin 125, 202-209 të K.Pr.Civile;

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkeses se pales paditese per heqjen e mases se sigurimit te padise te vendosur nga gjykata me vendimin date 14.06.2019.
2. Heqjen e sekuestros konsevative mbi aksionet qe i padituri Alban Jaho zoteron ne shoqerine "Digitalb" sha dhe konstatimin e shuarjes se garancise bankare te leshuar nga "Tirana Bank" sha me Nr.CO914/170619 date 18.06.2019.
3. Kundër vendimit mund të paraqitet ankim i vecante në Gjykatën e Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga e nesërmyja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Tiranë, më datë 25.10.2021.

SEKRETARE

GENCJANA DADA

GJYQTARE

ALMA KODRALIU

Vendimi mori formë të prerë pasi

nuk u ankimua më dt 06/12 2021

Tiranë më dt 13/12 2021

K / SEKRETARE

ADELA ÇINARI

VËRTETOHET NJESIA
ME ORIGINALIN

K / SEKRETARE SHOQËRI
ADELA ÇINARI

PULLE TARIF

TIRANË

20 LËK

R.SHIQIPERIS

Tiranë 13.12.2021.